

VENDIM
Nr.241, datë 19.4.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.335, DATË 23.6.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 1 të vendimit nr.335, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Enti prokurues të përdorë procedurën e prokurimit “Tender i hapur ndërkombëtar”, kur vlera e përlllogaritur e kontratës për prokurimin e ndërtimeve është mbi 1 000 000 000 (një miliard) lekë. Prokurimet e ndërtimeve, për vlera nga 200 000 000 (dyqind milionë) deri 1 000 000 000 (miliard lekë), publikohen (në anglisht) edhe në një gazetë ndërkombëtare me tirazh të mjaftueshëm për të tërhequr konkurrencën ndërkombëtare.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyretare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha